



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 124

Prishtinë, më 11.9.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović, Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi, Salih Morina.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.7.2013,
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.7.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.7.2013.

3. Shqyrtimi i plan programit për sesionin vjeshtor

Kryetari Nait Hasani ju dëshiroj mirëseardhje anëtarëve të komisionit në sesionin vjeshtor dhe njoftoi se kjo mbledhje do të shfrytëzohet për renditjen e punëve të komisionit që presin për shqyrtim në bazë të raportit me shkrim që kishin para vedit, njëherit falënderoi komisionin për punën e kryer gjatë sesionit pranveror. Pasi që janë caktuar zgjedhjet lokale dhe do të paraqesin ngarkesë për punën e Kuvendit, kryetari sugjeroi që të propozohet nga anëtarët e komisionit mënyra e punës së komisionit, p.sh. të zvogëlohet numri i mbledhjeve të komisionit etj, por ato që mbahen, të janë sa më efikase. Sipas raportit të përgatitur nga stafi (strategjia legislative e reviduar nga Qeveria), ai në vazhdim njoftoi me ecurinë e projektligjeve që janë shqyrtuar në komision dhe ato që nuk janë shqyrtuar si dhe për ato që është deshtë të arrijnë në Kuvend por nuk kanë arritur. Sa i përket monitorimit të filluar të ligjeve në komision, theksoi se nuk është përmbush obligimi financiar nga MMPH, ndaj nga komisioni kërkoi të propozohet mënyra e punës me projektligjet në procedurë, por paraprakisht u caktuan dy grupe punuese :

-për “**Zymin e Hasit**” : **Daut Haradinaj-kryesues, Liburn Aliu dhe Nait Hasani** (Daut Haradinaj propozoi tërë komisionin për grup punues çka nuk u kundërshtua nga anëtarët prezent),

- për “**Kimikate**” : **Nijazi Idrizi-kryesues, Sevdije Lama dhe Rasim Demiri.**

Kryetari Nait Hasani në vazhdim kërkoi zëvendësimin në grupet punuese të Salih Morinës për shkak të kandidimit të tij në zgjedhjet lokale, por nuk kishte ndonjë propozim konkret, ndërkaq në vazhdim diskutoi edhe për disa çështje aktuale siç është Prevalla ku MMPH ka filluar aksionin me task forcën e themeluar për shkatërrimin e disa ndërtimeve në parcelën e caktuar, ndaj komisioni duhet të interesohet a është kjo rrugë legale apo jo.

Nijazi Idrizi pasi që u apostrofua nga kryetari për grupin punues për pyjet, propozoi modalitetin e punës së mëtejme rreth pyjeve, sidomos me FAO ku është angazhuar ajo, p.sh. të vizitohet një komunë dhe agjencia (propozim i kryetarit) për të aritur tek rezultati konkret pse nuk shkojnë punët si duhet rreth pyjeve.

Daut Haradinaj kërkoi që rreth fshatit Zym të punoi komisioni komplet, ngase për këtë ligj kanë kontribuar të gjithë grupet parlamentare në Kuvend, ndërsa në anën tjetër shumë pak kanë dhënë kontribut zyrtarët qeveritar, përkatësisht të ministrisë, ftoi komisionin në bashkëpunim efikas dhe të ndërmarr veprimet e duhura ngase nuk ka shumë nene. Sipas tij, komisioni do të mund dhe do të ishte mirë të përfundoi shqyrtimin dhe Amendamentimin e këtij projektligji deri 3 tetor kur është festa lokale e këtij fshati, ngase duhet të shfrytëzohet partneriteti me gjermanët të cilët kanë shprehur gatishmëri për të ndihmuar.

Sevdije Lama potencoi kërkesën e dërguar në MMPH rreth arqitektëve për udhëzimin administrativ të cilët ende nuk janë përgjigjur, ndërsa kryetari njoftoi se sekretari i MMPH pritet të arrij nga i cili do të kërkohet përgjigja, përndryshe komisioni mund të dërgoi edhe qëndrimin lidhur me mospërgjegjen nga MMPH.

Zyrtari i fushës në komision, potencoi faktin se komisioni (për fshatin Zym) do të ishte më efikase të punoi në grup punues me 2-3 deputet dhe me zyrtar nga MMPH dhe Ministria e Kulturës, për të rrumbullakësuar punën me miratimin nga komisioni, ndërsa **Daut Haradinaj** tha se kupton këtë sugjerim por pasi nuk ka shumë punë ky projektligj, do të jetë më efikase puna e komisionit bashkarisht.

Kryetari Nait Hasani propozoi që mbledhja e radhës të mbahet të martën në orën 11,00 për Zymin, ndërsa një ditë më vonë për Kimikate.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

